Poiché mancavano a Venezia i cavalli e le carrozze – lusso riservato e largamente usato nella villeggiatura – si andò sempre più sbizzarrendosi questa età spendereccia negli adornamenti di quella barca elegante, che era il mezzo ordinario di trasporto. Severe, ma inefficaci disposizioni emanò la Repubblica in merito alla costruzione delle gondole¹⁹ e dell’abbigliamento dei gondolieri proibendo gli abiti costosi di questi ultimi.

Ma in questa lotta tra la rigida severità del magistrato e la tenace disobbedienza dei sudditi, vinse quest’ultima sin dal secolo XVII quando “le trasgressioni che si commettono hanno la sola origine della vanità e dell’ambizione”, come ebbe a dire un decreto dei Provveditori alle Pompe nel 1653, “(perciò) siamo andati studiando di appagar questa con qualche concezione per avanti non praticata”.

Concezione che iniziò, ma che non ebbe più limite nel secolo XVIII.

Il lusso esagerava nelle feste, nei ricevimenti, nelle nozze ecc.²⁰

Specialmente nelle conversazioni (ricevimenti) è questo secolo il regno della donna, della sua grazia e del suo sfrenato lusso. Fra l’agitazione dei ventagli ed il fruscio delle seriche gonne, fra giochi e danze, passavano le serate in ozio ed in vita lasciva.

Nel secolo decimottavo, i giorni di carnevale sono giorni di allegria vertiginosa. Nel giovedì grasso il popolo, alla presenza del Doge, della Signoria e degli Ambasciatori, si dà alle più pazze gioie e baldorie. La partecipazione di tante autorità dimostra quale e quanta fosse l’importanza che si dava alle feste del carnevale. Feste che iniziavano il 26 dicembre per non aver termine che il martedì grasso e per riprendersi di nuovo nei giorni della Fiera di Ascensione. Non che in quaresima e nelle altre stagioni non si trovasse modo di nuovi svaghi. L’anno fu un continuo carnevale²¹.

Le sagre dei Santi titolari delle contrade, i balli all’aperto, nei campi e nei campielli, l’elezione del pievano, le regate delle cariole, il “fresco” (passeggiata in gondola scoperta) che iniziava il giorno di Pasqua, la Fiera dell’Ascensione, le villeggiature estive che si protraevano fino all’autunno inoltrato; tutto era predisposto a dipartire l’anno in tante fasi di tempo carnealesco; sicché si può affermare che l’anno Veneziano fu tutto un carnevale continuo.

Oltre alle feste all’aria aperta, altri svaghi cercavano i patrizi ed i popolani nei luoghi di pubblico ritrovo, nei teatri, nei ridotti, nei circoli, nei caffè e nelle osterie.

E non solamente vi partecipavano i patrizi, ma, sfarzosamente, anche la nuova borghesia, e, nella sua semplicità, anche il popolo minuto che pur trovava il tempo a divertirsi dopo il ben poco lavoro giornaliero e nei tanti frequenti giorni festivi.

È pur vero quello che afferma il Dudan circa il rispetto che avrebbe dovuto avere Napoleone verso “il gigante che spossato ed adormentato al quattordicesimo secolo della sua vita viveva senza ledere alcuno”, ma è altrettanto vero che, non essendo stato possibile nella Repubblica un mutamento

¹⁷ Arch. di Stato, M.C. Colombo, c. 51, 16 apr. 1763.

¹⁸ Molmenti, op. cit., vol. III, p. 302.

¹⁹ Il governo diede alle fiamme una gondola fabbricata col fondo tutto di rame, di un gentiluomo della casa Moro.

²⁰ Interessanti le note di spese occorse per l’allestimento di nozze (vedi Molmenti, op. cit., vol. III, p. 342, nota 2^a).

²¹ I giovani patrizi, quasi per rifarsi della sregolata vita carnealesca, si davano a sollazzi più salutari. Al bersaglio di Sant’Alvise e di San Bonaventura si cominciava a giocare il gioco del *calcio*, da giovani nobili, vestiti leggeri e spediti, con berretti a piume bianche o nere, secondo le due parti del Monte o del Piano ... Erano inoltre in voga tra i nobiluomini il gioco della racchetta ... ed il gioco del pallone (Molmenti, op. cit., vol. III, p. 199).

radicale della costituzione antiquata dello Stato-Città, l'ordinamento stesso, caduto nella corruzione morale e fisica della vita della stessa classe reggitrice, accelerava la fine.

Quando in uno Stato aristocratico, come fu la Repubblica di San Marco, i componenti l'aristocrazia, anziché prendersi cura delle mansioni che conferiva loro nel Maggior Consiglio la stessa posizione sociale, erano diventati i cicisbei delle dame; e quando il parrucchiere, fra una incipriata e l'altra, portava di buon mattino – ed era mezzodì – le ultime notizie politiche e sociali, non è chi non veda chiaramente che per quello Stato tutto sia finito e che inesorabilmente si debba procedere alla sua sepoltura, sia pur adagiandolo in una tomba dove il lusso più sfrenato diventa suo ornamento, dove lo schiamazzo del carnevale suona da marcia funebre, e dove un Napoleone funziona da becchino.

6. Sacrificio necessario

Nelle conferenze del Congresso di Utrecht, apertesesi il 29 gennaio del 1712, alle varie questioni delle potenze interessate che fino allora erano state in guerra, se ne aggiunse un'altra importante questione circa l'ordinamento da dare all'Europa risolvendo anzitutto la questione italiana.

L'Italia aveva assistito alla formazione ed al consolidamento degli Stati europei, sempre portandone il grave peso per le mire che ognuno aveva su di lei. Spagnoli, francesi ed austriaci si contendevano il predominio sulla Penisola. E pensare che la soluzione migliore avrebbe dovuta venire dall'interno, come più tardi avvenne.

L'unità italiana non fu ottenuta, grazie a Dio, per opera della comunità degli stati, nemmeno quando questi si interessarono in merito. Ciò fu un bene per l'Italia. Perché in tanto è solida e consistente un'unità nazionale, in quanto la sua forza di coesione le proviene da vari elementi che la costituiscono e non già da reagenti esterni.

All'epoca della Conferenza di Utrecht, come prima e come in seguito sino alla fine della Repubblica e sino ai primordi del secolo XIX, la forza di coesione degli elementi italiani era polarizzata anziché attratta, perché troppo ugualmente importanti erano gli Stati principali, troppo diversa era la loro costituzione, diverse le loro direttive, perché tutti potessero, come poi avvenne, entrare nell'orbita di Uno solo che, prima come potenza egemonica, e poi confondendosi in un tutto, avesse data l'unità all'Italia.

Venezia, Savoia, Stato Pontificio e Napoli – lasciando fuori i vari Ducati e Principati – avevano un passato troppo disunito, anzi antitetico, perché fosse possibile trovare fra di loro un compromesso di connivenze, specialmente all'epoca di cui parliamo.

Tutti i principi italiani avevano inviato i loro ministri ed i loro rappresentanti ad Utrecht, ma solamente Venezia e Savoia avevano sede nel Congresso. Quindi una prima, forte selezione era così avvenuta fra gli stati italiani, ma ancora rimanevano due inconciliabili rivali. Anche se i ministri italiani, unitisi attorno al Ruzzini di Venezia, ebbero a dichiarare che riconoscevano nella Repubblica la principale Potenza e protettrice d'Italia, fu subito aggiunto: “nelle presenti congiunture”. Fu allora che il Ruzzini, alla proposta dei ministri di Savoia e di Toscana per la costituzione di una confederazione italiana, si recò il 13 maggio ad una conferenza col ministro inglese lord Straford a cui espose il grande progetto.

Se le intenzioni del governo inglese fossero serie quando il suddetto ministro Straford assicurò pieno appoggio alla realizzazione del grande sogno italiano, lo dimostra il fatto che, malgrado assicurazioni e buone parole in merito, non appena, per opera specialmente degli intermediari italiani, la Conferenza di Utrecht mise l'accordo in Europa, di questa Confederazione italiana non si parlò più, né dagli italiani né tanto meno dal ministro inglese che aveva condotto a buon porto gli interessi del suo paese.

Ma forse il motivo vero, per cui non si realizzò allora tale progetto, fu che in una eventuale Confederazione italiana, non si sapeva quale Stato dovesse conservare l'egemonia. E diciamo subito: Venezia o Savoia?

Continuatrice delle glorie di Roma, Venezia per quattordici secoli aveva mantenuto alto il nome e le glorie dell'Italia, ma, giunta oramai nell'estremo limite della sua esistenza, avrebbe portato in una Confederazione italiana in cui avesse tenuta l'egemonia, i germi malati della sua senilità. Del resto Venezia disprezzò sempre la terraferma, nel senso che il suo impero, unico nel suo genere, si era esteso su isole e su punti sparsi del litorale²².

Lo Stato giovane di Piemonte, al contrario, era vivificato di nuove energie che avrebbero potuto sopportare il peso di una egemonia nella Confederazione, nella quale avrebbe portato i germi nuovi della sempre giovane razza italiana.

Ma non era ancora questo il tempo.

Come anticamente esisteva la consuetudine di sacrificare del puro sangue nelle fondamenta delle nuove costruzioni materiali ed ideali, ugualmente nell'inscrutabile Mente Divina era stato deciso un grande sacrificio nel cui sangue dovessero posare ed amalgamarsi le fondamenta dell'Unità Italiana.

Ed il sacrificato va verso la morte con il sorriso sulle labbra, accompagnato da canti e suoni di gioia, contento e pago della grande missione che Iddio gli riserva persino nella morte.

Capitolo Secondo

IL SETTECENTO DELL'ALBANIA TURCA

1. Generalità

Quando, dopo le gloriosissime gesta degli schipetari guidati dal Genio del loro Re Giorgio Kastrioti, anche l'Albania dovette soggiacere alla dominazione turca, la Porta mise in opera tutta la sua abilità asiatica perché non vi fosse più possibilità alcuna di riscossa. Essa volle pertanto che quella parte dell'Albania caduta in ischiavitù – parte che verso il nord si estendeva sin oltre Antivari e confinava con l'altra parte, detta Albania Veneta – si amministrasse suddivisa in diverse province autonome, governate da capi i quali, anche se albanesi, erano messi in condizioni di tali rivalità reciproche da non potersi più affratellare. Rivalità che bene spesso culminavano in lotte fratricide, alimentate dalla Porta, la quale sorrideva maliziosamente ogniqualevolta periva il fiore della gioventù albanese. Si decimavano così questi valorosi che una volta avevano tenuto duro, barriera insormontabile, sicuro scudo all'Europa intimidita dal Turco invadente. E quando le guerre civili parvero ancora troppo poco per una decisa, sistematica decimazione, gli albanesi furono inviati a combattere in lontanissime regioni dove infieriva la guerra, costituendo – malgrado tutto – le più salde ed operose truppe dell'esercito ottomano.

Messo in evidenza quanto sopra, si potrà bene capire che anche l'elemento religione si prestò magnificamente al gioco turco. Quando si parlerà quindi delle lotte che seguirono in seguito a vessazioni religiose, si dovrà dare all'elemento religione un'importanza occasionale, messo in evidenza dalla Porta soltanto per sfruttarlo al massimo ai danni della Nazione Albanese. Perché il Pascià che, ad esempio, proporrà ai coltivatori cristiani il dilemma: o cambiar di religione oppure rimanere privi di terra, sarà nuovamente lui che si varrà dell'opera dei Cristiani Albanesi, quando non lo suggerirà più l'avidità egoistica della ricchezza, ma lo guiderà, verso l'opposizione alla Porta, la voce del Sangue²³. E che l'elemento religione non fosse l'unico sfruttato dalla Porta per immiserire gli Albanesi, è

²² Dudan: Venezia e Albania: Le tendenze politiche Veneziane ed il dominio della Serenissima. Su "Albania" I – Istituto di Studi Adriatici – Venezia.

²³ Il 15 settembre 1621 il Vescovo di Sappa, Pietro Budi, scriveva: "I capi di quei Populi sono la maggior parte miei parenti, et amici strettissimi, così ancora i principali Turchi in quei paesi, i quali hanno scoperto l'animo loro, et con detti Capi principali si è concertato il modo facilissimo di effettuare le principal fortezze in quei paesi..." (Relazione fatta all'Illustrissimo e Reverendissimo signor Cardinal Gozzadino dal Vescovo Sappatenze e Sardanenze, Pietro Budi, di Roma li 15 sett. 1621 – Arch. Stato Venezia: Busta Miscellanea di Atti diversi manoscritti – Filza N° 38/2/).

III

INTERVISTË E INJAC ZAMPUTTIT E VITIT 1993 DHËNË DREJTUESIT TË EMISIONIT TË GJUHËS SHQIPE TË RADIO VATIKANIT, Don David Gjgja.

[Shënim: *Intervista është transkriptuar nga Jozef Zamputti sipas inçizimit të Radio Vatikanit.*]

Ju po më pyetni diçka për jetën time dhe për formimin tim kulturor. Jeta ime asht jeta e një jetimi të mbetun pa babë kur isha një vjetit e gjysë me një nanë e tri motra në kohën ma të keqe të shekullit tonë. Dy vjeç e gjysë pësova tronditjet e gjyleve malazeze që binin edhe në oborrin tonë. Pastaj vitet e vështira të pushtimit austriak me mungesat që dihen. Mbas luftës motra e madhe u ba mësuese dhe jeta jonë nisi diçka të sistemohej. Jam rritë në shkollën saveriane, kam ba tri vjet shkollë të mesme në Itali. Pastaj, sikundër ishte zakoni në ato vitet e para të administratës shtetnore kur mungonin kuadrot, hyna mësues 21 vjeçar po në Kolegjin Saveriane në mënyrë private, jo shtetnore. Këtu pata fatin e madh të isha për gjashtë vjet kolegu i Ndre Mjedës që më qindroi shumë shumë afër e më deshë shumë. Pata edhe fatin, ta tham kështu me sinqeritet, të bahesha krahu i djathtë i Atë Zef Valentinit, me të cilin nisëm e çuem përpara albanologjinë saveriane. Edhe mbas luftës, nën regjimin komunist, mbas dy vjetësh që qëndrova larg familjes në Gjinokastër, pata fatin të thirresha pranë Institutit të Studimeve që Koliqi me Valentinin kishin krijuar dhe që mori emnin Instituti i Shkencave e aty kam punue tanë jetën time të kësaj periudhe deri më 1975 kur dola në pension 65 vjeç. Por edhe mbas pensionit unë kam vazhduar punën dhe kam botue pesë vëllime dokumentacioni ashtu sikurse e kishe zakon unë.

Ju po më pyetni tani se ç'vënd zen vepra ime e fundit në lidhje me Fishtë në veprimtarinë time të gjatë në fushën e kulturës. Do të tham të vërtetën se puna ime në fushën e historisë ku kam punue ka qenë përherë e mbështetun në burime primare, dmth burimore, sepse me një gjykim të përgjithshëm e kam konsiderue bibliografinë ekzistuese pak a shumë të infektueme qoftë nga niveli i studimeve, qoftë nga mungesa e burimeve, qoftë edhe nga paragjykimet e keqdashjet. Kështuqë unë i jam drejtue burimit primar gjithmonë. Edhe 10 vëllimet e mija të botueme me dokumentacionin arkivor dishmojnë për bazën ku jam mbështetun unë për studimet e mija në degët e ndryshme humanitare. Gjatë punës sime nuk kam harrue kurrë se unë ma parë kam qenë pedagog, kam qenë gjuhëtar dhe letrar. Kështuqë në studimet e mija jam futë shpesh edhe në këto fusha të gjuhësisë, letërsisë, sociologjisë, pedagogjisë etj. Vepra e fundit mbi Fishtë e ban dëshmi këte, dmth që unë nuk kam harrue kurrë të kem qenë i tillë. Por, para kësaj veprë, para veprës së Fishtës, unë kam marrë në analizë dy vepra të tjera të Kadaresë dhe asht "Autobiografia e popullit në vargje", asht edhe "Eskili", ku kam shprehë mendimet e mija, gjykimet e mija, kam dhanë kritikën time, kam ba plotësime, kam ba interpretime të reja etj. etj. Kjo vepër asht e shkrueme pesë vjet ma parë dhe duhet të kishte dalë ajo përpara kësaj, por kështu erdhën punët mbas revolucionit demokratik: jo mungesa e letrës, jo kjo, jo ajo. Megjithatë mund t'ju siguroj se ajo vepër që unë e kam quejtë "Ekskursion në dy vepra të Kadaresë" asht në proces të shtypit e shpejt, ishalla, do t'jua dërgoj edhe ju personalisht ndonji kopje. Do të kemi kohë të bisedojmë pastaj edhe për ato dy vepra. Veprën për Fishtë, sikundër e tham disa herë gjatë trajtesës, e ndjeva për detyrë ta shkruajshe për të dhanë një kontribut që breznitë e reja t'i dinë disa gjana që ua kanë mbulue qëllimisht. Fishta nuk asht studjue kurrë e ata s'dinë kurrë për Fishtë. Kjo ishte në substancë përgjigja e pyetjes së parë.

Ju konstatoi pastaj se në këtë vepër kushtuar Fishtës unë prek shumë çashtje delikate në lidhje me zhvillimin e sotëm letrar e kulturor dhe kërkoni të dini mendimin tim për këto problem aktuale. Duke i shtruar çashtjet e ndryshme anësore, në veprën e Fishtës, unë kam dashtë të ve në dukje ndërlidhjet që ka çashtja kryesore e studimit të figurës dhe veprës së Fishtës me shumë probleme të shtruueme e të zgjidhuna njëanshmërisht gjatë gjysëm shekullit të regjimit socialist me anën e diktatit dhe metodës së padiskutueshme të realizmit socialist. Natyrisht, për secilën çashtje që shtroj, unë jap edhe mendimin tim të pavarur dhe pa diktat. Por çdo gja e tham në mënyrën sintetike, sepse

s'kam kohë të baj trajtesë. E pranoj se çdo çashtje që shtroj në këtë vepër do të lypte trajtesë më vete, por kam pëlqye vetëm sa t'i preku çashtjet e të jap mendimin tim, sepse, përndryshej, do të ishte mbulue çashtja kryesore që ishte figura dhe vepra e Fishtës. Probleme aktuale ka shumë në letërsi e në kulturë. E kjo ka shkaktue që të krijohen dy fronte të ndryshme këtu në Shqipëri. Fronti i autorëve militantë të realizmit socialist që, me Ismail Kadarenë në krye kërkon "rinovimin" letrar e kulturor duke spastrue veprat e veta nga partishmëria për të cilën i detyronte diktati. Asht krijue edhe fronti i autorëve që detyrimisht qëndruen në heshtje ose nuk mujtën me shkruie si deshtën gjatë gjysëm shekullit socialist. Natyrisht ky front asht në hapat e para dhe gjindet përballë frontit të madh që ende lidh e zgjidh në çashtjet e kulturës e të artit, që ka në dorë gjithnji mjetet e shtypit e të informacionit, megjithëse janë ba e po bahen përpjekje për të dalë nga kjo situatë. Rezultati kryesor asht se sot në Shqipëri ka shumë organe shtypi ku çdo mendim mund të shprehet. Ky asht një sukses, mbas mendimit tim, por disa organe të së kaluarës qëndrojnë gjithnji në krye të punës me peshën sasiore sidomos dhe me metodologjinë e rinovuar të së kaluarës. Këto janë, natyrisht, dy fronte që luftojnë njëri me tjetrin.

Në pyetjen e tretë ju shtroni çashtjen e ndryshimeve që janë ba e cila asht prirja e kulturës së soçme demokratike në Shqipëri. Unë jam i izoluem tashma e nuk dal nga shtëpia, jam në moshën 83 vjeçare e do ta ruej veten edhe për disa kohë. Por sinqerisht jam i bindun se intelektualët e sotëm duan dhe gëzohen se janë tashma të lirë të shprehen sikundër mendojnë në fushën e artit, të shkencës, edhe të mendimit filozofik. Veçse metodologjia socialiste peshon gjithnji te individët dhe kjo asht një gja e kuptueshme sepse asht një kulturë gjysëmshkullore metodologjike dhe metodike. Një sukses organizativ dhe i dukshëm asht arritë në institucionet shkencore që konvergojnë në Akademinë e Shkencave. Jam informue se po bahen plane e po zbatohen dita ditës për të rishikue e rindërtue shkencat shoqërore ku shtrembnimet kanë pasë rast me u futë ma lehtë. Në fushën e historisë p.sh. e kemi pasë të ndalueme rreptësisht jo vetëm që të futeshin në punë studimet e çmueshme të Atë Zef Valentinit, por as emni i tij nuk duhej përmendë. Duke pasë qenë unë nxanës i Valentinit dhe kolegu i tij në themelimin e albanologjisë saveriane gjatë gjithë punës sime në fushën e historisë e kam ndie keq peshën e tij edhe përherë më qitej përpara emni i tij, figura e tij si anmik i popullit, ndikimin e të cilit unë e ndieja e më akuzonin se e reflektoja në punimet e mija. Sot, përkundra, Instituti i Historisë që drejtohet prej historianit Kasem Biçoku, një ish kolegu im i dikurshëm, po e rivlerëson gjithë veprën e Valentinit dhe asht shtrur në plan që kjo vepër kolosale të ndihmojë për rishikimin e përgjithshëm të historisë së Shqipërisë të hartuar gjatë regjimit komunist. Vepra e Valentinit ka dy anë kryesore: asht ana burimore dhe ana studimore. Të dyja këto aspekte të veprës së tij do të futen në punë. Në fushën e letërsisë Fishta, Konica, Koliqi, e ndonji tjetër që u harruen gjatë gjysmëshekullit komunist do të zanë vendin që u përket e do të futen në shkollë. Do të rishikohen edhe studimet e autorëve të studjuem me metodat e realizmit socialist dhe do të dalin në shesh dukuritë e veprave të tyre si të Naimit etj. që metoda e realizmit socialist i ka lanë në heshtje e i ka mbulue. Mue më duket se ky asht sukses i kryesor për kulturën shqiptare dhe se kjo do të jetë rruga e drejtë për ta ushqye e për ta çue përpara. Domosdo do të ketë mendime e drejtime të ndryshme, edhe të kundërta, por sukses i madh asht se çashtjet mund të diskutohen lirisht. Kam përshtypjen se, domosdo, në një shkallë ma të naltë në kulturën shqiptare sot po ndihet fryma e viteve '30, por ka një ndryshim shumë të madh se ideologjia marksiste komuniste nuk asht ma militante siç ishte në vitet '30, madje ka asish që e ruejnë përbrenda vetes, por përpiqen të duken të çliruem prej saj.

SHKENCËTARËT PUNONIN ME SHPATËN E DAMOKLEUT MBI KOKË

INTERVISTË ME INJAC ZAMPUTIN, STUDIUESIN
DHE HISTORIANIN E NJOHUR SHQIPTAR

Epika Fishtjane është historia e Rilindjes; folklori në të gjitha dukuritë deri te Këngët e Kreshnikëve është historia e popullit. Veprat e shkrimtarëve të vjetër, përveç vlerave që kanë për shqipen historike, kanë edhe faktorin atdhetar të bashkuar në binomin Fe e Atdhe.

Studiuesi dhe historiani i mirënjohur Injac Zamputi ka kontribuar në mënyrë të ndjeshme në njohjen e mesjetës dhe të letërsisë së vjetër shqipe. Përmes mjaft studimeve me karakter historik, etnik, sociologjik, gjuhësor e letrar ai ka dëshmuar visaret shpirtërore e fizike të popullit tonë, veçoritë dhe kontinuitetin e tij kulturor. Duke qenë njohës i mirë i paleografisë dhe i latinishtes mesjetare, Zamputi mbloshi, sistemoi, transkripto dhe botoi një fond dokumentash me vlerë për Historinë e Shqipërisë, të nxjerra nga arkivat e Vatikanit, Venedikut, Raguzës (Dubrovnikut) etj.

Ndonëse në një moshë të thyer, 83 vjeç, Injac Zamputi, intelektual i shkolluar dhe i formuar në Perëndim, vazhdon të punojë ende me pasion dhe energji të mëdha. Është autori i monografisë shkencore: "Fishta – Koha, Njeriu, Vepra" (1993), "Ekskursion në dy vepra të Kadaresë" (1993) si dhe i mjaft artikujve e studimeve të botuara në organet shkencore e letrare.

Prioriteti i objektivitetit shkencor

- Studimet historiografike për Mesjetën janë të pakta, sepse shkenca shqiptare është marrë shumë pak me këtë periudhë. Cili është mendimi juaj për studimet historike shqiptare për Mesjetën? Rezultatet e deritanishme dhe metodologjinë?

- Mesjeta e hershme, jo vetëm për Shqipërinë e për shqiptarët, po për të gjithë popujt e Evropës, është e mbushur me boshllëqe të shkaktuara prej shumë faktorëve që s'është këtu vendi të rreshtohen. Mesjeta shqiptare është e pasqyruar sidomos në historiografinë bizantine dhe në burimet arkivore perëndimore. Veçse, kush më shumë e kush më pak, popullsitë që bënin pjesë në Perandorinë Bizantine, pasqyrohen në historiografinë vetëm në ato momente kur gjykohej se pesha e tyre ishte e rëndësishme për vizionin perandorak në përgjithësi. Këtë rrugë ndjek edhe dokumentacioni perëndimor në lidhje me interesat e shteteve të ndryshme për Shqipërinë e për shqiptarët. Ballkanologët e së kaluarës kanë bërë hulumtime qoftë në bibliografinë, qoftë në dokumentacionin arkivor. Tri Akademitë e Shkencave, ajo e Zagrebit, e Sarajevës dhe e Beogradit, në shekullin e kaluar dhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë, duke hulumtuar ndër arkivat e ndryshme evropiane, kanë përfshirë çdo dokumentacion që intereson edhe vendin e popullin tonë deri në Vlorë. Po kështu, por në masë më të reduktuar, kanë vepruar hulumtuesit grekë për pjesën jugore të vendit tonë. Natyrisht, pavarësisht nga synimet, kjo punë del e frytshme për studimet tona meqë shkenca shqiptare s'ishte në gjendje ta bënte. Me këto burime, dmth bibliografi e dokumentacion, albanologët dhe punonjësit e historisë kanë vënë bazat për historinë mesjetare shqiptare. Sigurisht edhe shkencat anësore kanë ndihmuar e do të ndihmojnë për të shpjeguar, për të saktësuar e plotësuar boshllëqet. Arkeologjia, për shembull, përveçse është me peshë të madhe për historinë e lashtësisë, na ka ndihmuar dhe do të na ndihmojë për Mesjetën. Dy mbishkrime të zbuluara, i pari më 1901 dhe i dyti pas tetëdhjetë vjetësh, na kanë dhënë mundësi ta projektojmë Principatën e Arbërit qoftë në të kaluarën, qoftë në të ardhmen e organizimit të saj në shtet. Unë jam marrë me këto dy mbishkrime dhe këto ditë përfundova trajtesën me titull: "Dy mbishkrimet e fillimit të shekullit XIII dhe lidhjet e tyre me Principatën e Arbërit". Me këtë trajtesë shpreh bindjen se toka-mëmë ruan gjithnjë të tilla visare dhe se duhen vazhduar hulumtimet.

- *Ku qëndron rëndësia e burimeve për studimin e historisë së Shqipërisë, e kemi fjalën kryesisht për raportet që kanë dokumentet me udhëpërshkrimet, relacionet, përshkrimet etnografike, letërsinë gojore etj.?*

- Me përpjekje të vazhdueshme besoj se historiografia shqiptare mesjetare do të pasurohet edhe më shumë me punën hulumtuese në të gjitha këto burime që rreshtoni në pyetjen. Me shembullin që dhashë për mbishkrimet e Arbërit desha të pohoj pikërisht se shkencat anësore për të cilat ju bëni fjalë në pyetjen tuaj i vijnë në ndihmë historisë së çdo kombi, pra edhe kombit shqiptar. Veçse duhet bërë një punë sistematike dhe e koordinuar që të shpejtohen hapat. Mesjeta, sa më afër nesh të vijë, aq më shumë vjen duke u pasuruar me burime aktrivore që gjenden ende të pazbuluara ndër arkivat e shteteve me administratë të organizuar, siç është në kryekreje Republika e Venedikut që i jep lëndë dokumentare gjithë Evropës. Seria dokumentare e botuar nga Atë Zef Valentini pas Luftës së Dytë Botërore është dëshmitare për visaret që ruhen edhe për historinë shqiptare. Vëllimet e shumta të Valentinit janë përfshirë me titullin "Acta Albaniae Veneta" që do me thënë se ka nxjerrë vetëm dokumentacionin që i intereson Shqipërisë. Përveç Venedikut, për historiografinë shqiptare kanë rëndësi arkivat e Romës, të Napolit, të Spanjës, të Republikës së Raguzës (Dubrovnikut) dhe pothuaj të cilitdo qytet të Perëndimit që pati interes për Shqipërinë e për shqiptarët. Kemi pasur disa rezultate në veprën e hulumtimit të cilat na japin guxim për të pohuar se puna duhet vazhduar. Për shembull Arkivi i Propaganda Fide-s na ka dhënë Relacionet dhe korrespondencën e shekujve XVII-XVIII. Me këto relacione kemi arritur ta njohim me shumë hollësi jetesën e zonave malore të shekullit XVI ku ishte përqendruar rezistenca ndaj pushtuesit dhe sot e njohim atë jetesë 300 vjet më thellë se sa e njihnim deri në prag të Luftës së Dytë Botërore. Ky shembull duhet t'u japë nxitje studiuesve për ta vazhduar veprën hulumtuese në të gjitha fushat, të mos tërhiqen para dështimeve që mund t'u dalin rrugës. Udhëpërshkrimet duhen vlerësuar për të dhënat që, nganjëherë, zëvendësojnë dokumentacionin. Tek ato duhen vlerësuar të dhënat objektive të çdo karakteri duke i zhveshur nga gjykimet subjektive, impresioniste kalimtare dhe, sidomos, nga qëllimet për të cilat gjykojnë fakte, njerëz e ngjarje. Në këtë mes duhen përgatitur kuadrot që t'i kushtohen gjuhës me të cilën janë ndërtuar dokumentet dhe udhëpërshkrimet, që duhen kuptuar mirë sepse shpesh ka ndodhur të kuptohen keq. Shpesh kemi udhëpërshkrime të shkruara prej emisarëve që i dërgonin Lindja e Perëndimi për të ditur me hollësi gjendjen e vendit për ta vlerësuar e inkuadruar në planet e strategjisë së tyre. Ndryshojnë nga e zakonshmja, ta zemë, Relacioni i Marin Bicit, ai i Françesk Bolicës, ato të Frang Bardhit e të tjera deri te Relacioni i Vincent Zmajeviqit (1703), po siç ndryshojnë Relacionet e shekullit XVI kur po përgatitej sulmi total kundër Perandorisë Osmane që çoi në Luftën detare të Lepantos.

Vështirësitë në përdorimin e terminologjisë shkencore

- *A keni pasur pengesa dhe censurë në botimin me dokumente për historinë e Shqipërisë?*

- Pengesa jo, por kritika po, sidomos për Relacionet e nxjerra nga Arkivi i Propaganda Fide-s që i botova në vitet gjashtëdhjetë.

Puna ime studimore ka karakter primar dhe ja përse: unë kam punuar vetëm me dokumentacion për të ndërtuar historinë politike që nga fundi i shekullit XV e deri në fundin e shekullit XVII. Ishte ky një terren i mbushur me fakte e ngjarje të dokumentuara, por ku nuk kishte kaluar më parë parmenda e bujkut. Për studimin e periudhave të tjera ka ndikuar shumë bibliografia ekzistuese dhe studiuesi është topitur dhe shpesh nuk ka mundur të jetë autonom. Në terrenin ku kam punuar unë, përveç botimeve dokumentare për të cilat fola më lart, nuk kam ndeshur në punime studimore për të qenë. Ekziston një heshtje pothuaj e plotë. Kjo ka ndodhur ndoshta sepse kjo periudhë dyshekullore është e mbushur me përpjekjet e shqiptarëve për liri e për çlirim, kur popujt e tjerë të Ballkanit ende nuk ishin organizuar për të rifituar lirinë, veçse aty nga gjysma e parë e shekullit XVII. Prandaj, në përgjithësi nuk kam pasur ndërhyrje as në botimin e dokumentacionit as në punën time studimore. Nëse kam pasur, kjo ka ardhur nga të paafët që ngurrnin të pranenin gjëra që nuk i

kishin dëgjuar kurrë. Veç kësaj, nuk më kanë lejuar të formuloja gjykime që të mos pajtoheshin me marksizmin e vijën e partisë, nuk më kanë lejuar të përdorja terminologjinë shkencore po për atë shkak e kështu me radhë. Këndeji rrjedhin dëmtimet që mund të hetohen në studimet e mia.

Unë konsiderohesha, siç kisha qenë, bashkëpunëtor i Atë Zef Valentinit në themelimin e në funksionimin e Akademisë Albanologjike Saveriane në Shkodër gjatë viteve tridhjetë, meqë isha mësues letërsie në atë lice. Hija e Valentinit dhe e edukatës sime më ka ndjekur kudo dhe, më 1967, u gjet rasti të më ballafaqohej botërisht me mbledhjet e zgjeruara ku u godit ideologjia e studimeve të mia.

Në proceset e shumanshme shkencore kam pasur ndërhyrje dëmtuese nga të paaftët dhe nga zelli i tepruar i tyre për të më futur në binarët e marksizmit. I afti, që mund të gjykonte drejt, ulte kokën siç e ulja domosdo edhe unë.

- A ka pësuar dëme historiografia jonë nga mënjanimi e moslejimi i botimit të studimeve të disa historianëve për shkak të luftës së klasave gjatë këtyre 50 vjetëve?

- Ka pësuar. Por mënjanimi e moslejimi i botimit ka ndjekur dy rrugë, dmth shkak i luftës klasore është zbatuar haptas ose i maskuar. Haptas ka qenë zbatuar kundrejt atyre që kishin qenë shpallur "armiq të popullit", kryesori i të cilëve ka qenë Atë Zef Valentini, studimet e të cilit nuk na kanë rënë kurrë në dorë dhe, kur na erdhën vëllimet e para të dokumentacionit venedikas, nuk na u lejua t'i fusnim në punë në studimet tona. Në shembullin e punës së tij u hartua një plan pune për të çuar ekipe në Venedik e në Dubrovnik për të nisur një punë totale në dokumentacion. Puna që u bë në këtë fushë doli me fryt, por dëmi që u shkaktua ka qenë edhe më i madh, sepse për kaq e kaq vjet u shpenzuan energjitë shkencore për një punë që ishte e gatshme, vetëm e vetëm se kjo punë nuk duhej përfillur në studimet tona. Këto energji që u shpenzuan në këtë punë mund të kishin qenë futur në një terren tjetër të shkencës historike dhe do të kishim rezultate të tjera. Por shkak i luftës klasore ka qenë dëmtues edhe brenda kuadrin që vepronte në sistemin e Institutit të Historisë e Gjuhësisë që, për një periudhë të gjatë, qenë nën një drejtori. Ambicjet personale të mediokërve gjenin terren të përshtatshëm jo vetëm për të shfrytëzuar punën e kuadrove të vjetër, por edhe për t'ua penguar botimin e studimeve atyre që ishin vënë në shënjestër dhe që punonin me shpatën e Damokleut mbi kokë. Shkak gjendej lehtë kudo që të vihej gisht. Synimi ishte, dhe shpesh realizohej, që i pafti donte t'i përvetësonte tezat e konkluzionet që kishin shtruar e formuluar të aftët e mbikqyrur. Por paftësia nuk të çon para dhe kështu shumë punime të përvetësuara, me vlerë për historinë e Shqipërisë, kanë mbetur ndër sirtarët e të paftëve. Dëmi është i madh sepse kanë mbetur shumë tema pa u shkoqitur, shumë probleme pa u zgjidhur që do ta kishin çuar historiografinë përpara.

- Ju jeni njohur kryesisht si studiues i mesjetës. A mund të na thoni cilat qenë motivet që ju shtynë të kryeni dy studime për Fishtën e Kadarenë?

Historiani, për të qenë i tillë, duhet të jetë i interesuar për të gjitha fushat e shkencave humanitare. Nëse lexohen me vemendje e jo me pasion dhe kureshtje për të renë, do të shihet se në këto dy vepra të mia të pleqërisë mbizotëron faktori historik i zbatuar në terrenin e krijimtarisë artistike. Epika fishtjane është historia e Rilindjes; folklori në të gjitha dukuritë deri te Këngët e Kreshnikëve është historia e popullit në jetesën e tij në mjediset e ndryshme; bota e lashtësisë greke është pjesë përbërëse e popujve autoktonë të Ballkanit. Para se të merresha në mënyrë profesionale me historinë kam qenë për 13 vjet mësues letërsie. Në moshën e pleqërisë sime nuk kam kohë as forcë të shtroj plane të reja për punën shkencore. Tri veprat e Kadaresë qenë për mua nxitje për të ritrajtuar problemet e shumta që shtrohen aty dhe për t'i zgjidhur sipas bindjes sime, bindje që është pjekur gjatë punës sime të gjatë shkencore. Këto bindje mendova t'ia bëj të ditur breznisë së re për të thyer akullin që na kishte ngrirë dhe që brezi i ri ta dijë se nuk është vija e diktatit që ndihmon për trajtimin e zgjidhjen e problemeve shkencore dhe artistike.

- Cili është gjykimi juaj për letërsinë e vjetër shqipe dhe përfaqësuesit e saj; si është pasqyruar ajo në historiografinë tonë letrare dhe në botimet e pasçilirimimit dhe ç'vend duhet të zërë ajo realisht në kulturën tonë kombëtare?

- Duhet një trajtesë e veçantë. Këtë çështje e kam prekur dhe trajtuar në punimin tim mbi Fishtën. Kam folur aty për kufizime që pësoi kjo letërsi dhe veçanërisht i kam kushtuar kapitullin e fundit ku kam vënë në dukje se veprat e Shkrimtarëve të Vjetër, përveç vlerave që kanë për shqipen historike, kanë edhe faktorin atdhetar të bashkuar në binomin Fe-Atdhe. Kam vënë në dukje se gjuha gegë-verbore ka vazhdimësi të pandërprerë qysh nga Buzuku deri te Fishta dhe është letrarisht e unifikuar, pavarësisht nga cila krahinë gege është ai që shkruan. Kjo përpjekje me këto rezultate nuk është marrë parasysh as në historinë e letërsisë shqipe as në hartimin e rregullave mbi të cilat u ngrit gjuha e sotme letrare. Kam shprehur mendimin e një kontributi të përshtatshëm që gjuha e nisur që nga Buzuku dhe e arritur te Fishta mund dhe duhet t'i japë gjuhës letrare.

Letërsia soc-realiste është dëshmi për një epokë

- Ç'mendim keni për letërsinë e pas 1944-ës, e quajtura e realizmit socialist? Mbi ç'kriterë duhet rishikuar ajo? A do të ketë kjo letërsi vlera për të hyrë në traditë apo do të mohohet tërësisht?

- Më duket se e çeka më parë këtë çështje. Unë dalloj historinë e letërsisë shqipe nga prodhimtaria artistike. Ndërsa e para duhet ritrajtuar, e dyta nuk duhet lëvizur. Edhe këtë çështje e kam trajtuar në librin tim mbi Fishtën. Kam folur aty për kufizimet që pësoi kjo letërsi në regjimin e kaluar me anë të diktatit dhe të konformizmit të shkrimtarëve. Unë jam kundër dy rrymave që janë shfaqur: kundër atyre që duan ta zhdukin prodhimtarinë e realizmit socialist dhe, sidomos, kundër atyre që duan ta "shtrydhin" nga partishmëria. Jo, kjo do të ishte tallje, do të ishte në vazhden e metodës së realizmit socialist që botimin e parë të një veprë e ndryshonte në botimin e dytë vetëm në ato pjesë që shkonin pas ndryshimeve politike të Partisë. Për mua, letërsia e realizmit socialist as nuk do të zhduket, as nuk do të preket. Ajo paraqet një epokë të jetuar prej popullit shqiptar dhe duhet të jetë dëshmitare për atë epokë.

- Me sa e keni ndjekur procesin letrar nga 1991 e këndeje çfarë ndryshimesh vini re në të dhe si e mendoni të ardhmen e letërsisë?

- Po vë re se disa shkrimtarë e poetë të realizmit socialist janë duke shkruar me frymën e re të çliruar nga diktati. Unë këtë punë e përsëris. Është një nga këshillat që kam dhënë edhe në veprën time mbi Fishtën: bëjeni kthesën në mënyrë burrërore, pa justifikime të tepruara, pa e mohuar të kaluarën tuaj. Mohoni veprën tuaj ku është për t'u mohuar, por mos kërkoni t'ia përshtatni situatës së re. Në vend që të shpenzoni energjitë për "spastrime", vijuni krijimtarive të reja. E ardhmja e letërsisë shqipe kërkon punë shumë dhe sinqeritet që i ka munguar letërsisë së realizmit socialist.

- Cili do të ishte, sipas jush, misioni dhe objekti i një historiografie moderne, historike apo letrare, në mënyrë që t'u shërbejë gjithë brezave?

- Rrjedhimisht me sa thashë, misioni i historiografisë shkencore dhe letrare është që breznitë e reja të mësojnë të përfitojnë prej sukseseve të paraardhësve dhe të hetojnë pengesat që do t'u dalin gjatë punës shkencore dhe artistike. Për t'ia arritur kësaj, shkencëtari dhe artisti duhet të synojnë të pajisen me filozofi e sociologji të shëndoshë. Për shkencëtarin duhet punë ngulmuese jo vetëm në veprën hulumtuese, por edhe në shpjegimin sa më të drejtë të ngjarjeve që kanë kushtëzuar të mirat e të këqijat e popullit shqiptar. Artisti, përveç kulturës shoqërore duhet që të jetë i pajisur me shijen artistike në shembullin e traditës më të mirë qysh nga kultura klasike e përfaqësuesve më në shenjë të epokave e të popujve të ndryshëm. Ajo që ka dëmtuar më fort artistët tanë, por edhe shkencëtarët,

ka qenë pikërisht kultura e kufizuar e tyre dhe e njëanshme. Kultura e gjerë duhet të jetë në bazë të punimeve shkencore dhe artistike.

Rezultatet e shkencëtarit janë fryte të një vetmie të madhe

- *A mund t'i bëni me dije lexuesit se me çfarë po merreni tani e ç'plane keni për më vonë?*

- Po shkruaj çdo gjë, qysh nga kujtimet familjare deri te kujtimet shoqërore. Konkretisht, në kujtimet e formacionit tim, kam synuar të mos e vë personin tim në qendër të vëmendjes, por mjediset shoqërore nëpër të cilat ka kaluar fëmijëria, adoleshenca, rinia dhe pjekuria ime. Janë punime tashmë të përfunduara dhe kërkojnë vetëm një rilexim për të mbushur e sqaruar disa boshllëqe. Kam pastaj në dorë disa tema që kam trajtuar dhe që nuk janë botuar sepse kanë mbetur pa përfunduar. Jam duke shkruar historinë e Kolegjes Saveriane ku kam qenë nxënës dhe mësues, ku kam qenë bashkëpunëtor dhe redaktor i revistës LEKA dhe sekretar i Akademisë Albanologjike për të cilën fola më lart.

Pyetja juaj mbaron me këto fjalë: "Ç'plane keni për më vonë?". Do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje ambicioze me fjalët e Aurel Plasarit kur bëri portretin tim në "Zëri i Rinisë" (13 gusht 1993): "Vepra e Zamputit (letrare e studimore) është fryt i një vetmie të madhe... Deri në atë shkallë sa blerësit e librit të tij më të fundit të shprehin habinë: Pse, gjallë qenka Zamputi?"

- *Ç' mesazh do t'u kishit përcjellë brezave të reja të studiuesve?*

Do të shtoj, në formë përmbledhëse, se rikonstruktimi i Akademisë dhe i institucioneve shkencore do të ketë për detyrë rishikimin e punës gjysëm-shekullore, jo për ta mohuar, jo për të mos e përfilluar djersën e punonjësve shkencorë, por për të vënë në vendin e duhur – qoftë në Institutin e Historisë, qoftë në atë të Gjuhësisë e Letërsisë – çdo gjë që diktati ka detyruar të heshtet, të fshihet ose të shtrembërohet....

Shkenca, si e tillë, ka kërkesat e veta rigoroze, nuk duron subjektivizëm as diktat. Krijimtaria artistike është personale, siç e thashë, pasqyron emocionet që shkaktohen nga jeta shoqërore, veçse as ajo nuk duron diktat, por duhet të ketë liri shprehjeje të mendimit filozofik-artistik.

Jaho BRAHAJ
Xhovalin KOLA

Botuar në gazetën RILINDJA më 5 dhjetor 1993.

INJAC ZAMPUTTI - BIBLIOGRAFI

[Shënim: *Po e sjellim bibliografinë siç e ka renditur vetë autori në vitet 1994-95 duke shtuar botimet pas këtyre viteve - J.Z.*]

I – Botimet e mija të viteve tridhetë deri me 1944

Në vitet tridhetë deri me 1943, me pak përjashtime, kam qenë mësues Gjuhe dhe Letërsije në gjimnaz-liceun të Kolegjës Saveriane të Shkodrës që drejtohej prej Jezuitëve dhe në Seminarin Papnuer ku dhania e mësimit bahej e përbashkët.

Kam qenë ndihmës i Atë Zef Valentinit për të përkohëshmen LEKA dhe për Albanologjinë Saveriane deri sa nënshkrova, me cilësinë e Sekretarit, Diplomat për anëtarët e Akademisë Saveriane.

Gjatë kësaj kohe kam botue novela, poezi, studime gjuhësore, vizatime për ngjarje shoqërore të ndryshme, portrete personazhesh, recensione, kritikë letrare dhe përkthime. Kam botue një melodramë në LEKA, pastaj dy libra me novela dhe librin e përkthyer të Shenjtes Terezinë të Krishtit Fëmijë.

Ishte zakoni aso kohe që botimet e rinisë të dilnin me pseudonim. Unë kam përdorë rreth 12 të tillë. Ka pasë edhe shkrime të mija që nuk kishin asnjë pseudonim.

Pseudonimi kryesor që kam përdorë në të përkohëshmen LEKA ka qenë ALES, por edhe ndonjë tjetër. Pseudonimin e ALES e kam përdorë edhe në të përkohëshme të tjera. Kritikat letrare i kam botue pa pseudonim. Shumë vonë dola me emnin tim të plotë.

Ruej kopjet e shkrimeve të mija të botueme, por ndonjena edhe më ka humbun. Aso kohe nuk e dija vlerën e bibliografisë personale dhe shumica e kopjeve që ruej nuk e kanë vitin as muejin e botimit, prandaj ndonjë mund të mos jetë i saktë.

I kam klasifikue shkrimet e mija, të botueme deri me 1944, në ketë mënyrë:

1 – Botime me karakter letrar

Ndër libra e fletore, Leka, 1935

Damiani Himariot, novelë, Leka, 1936

Damiani Himariot, melodramë, Leka, numër përkujtimor i vitit 1937 – libër më vete 1943

Nji parë dorca, Cirka, prill-maj 1937

Zemra njerzish, libër me novela – Shkodër Shtyp. “Zoja e Paperlyeme”, 1940

Atje nën hijen e Rozafës, libër me tregime – Ismal Mal’Osmani, Botonjës, Tiranë 1944

2 – Botime me karakter gjuhësor

Ku kjeme e ku po shkojmë, Zot. Dr. D. K., Cirka, prill 1938

Gjithkush atë të veten, Cirka, 5 korrik 1938

Aoristi shqip, Leka, kallnduer 1943

Po-hi dhe Jo-hi ndër bisedat tona, Kumbona e së Dieles, 1943

Germa A ndër përgjegjet-pëvetëse, Kumbona e së Dieles, 1943

Prap mbi Falemi Rregjineshën, Zani i Shna Ndout, Shtatuer 1943

Emëni dhe mbiemëni (llagapi), Shkëndija, 1943

3 – Vizatime me karakter shoqëror

Magazinë puthjesh, Gazeta Tomori, 1940

Kapela burrash për gra, “ “ “

Tri episode ndër karroca, “ “ 1941

Nana ka qitë në zjerm djepin tim, “ “ “

4 – Recensione dhe kritikë letrare-artistike

Bylbyli i Shkodrës, Leka, 1936

Recension për Fjalorin italisht-shqip të Atë Fulv Kordinjanos S.J., Leka, kallnduer-fruer 1939

- Tue rrahun fletët mbi "Bagëti e Bujqësija" të Naimit, Tomori, 1941*
- Atë Gjergj Fishta – gjeni shqiptare, gjeni botnore, Numri unik për Fishtën, i përkujdesun prej Atë Benedikt Demës OFM, Tiranë "Distapur", 1943, fq. 533*
- Kur flasim për të Mëdhaj, Leka, fruer 1943*
- Kur flasim për të Mëdhaj – replikë, Leka, prill-maj 1943*
- Zef Skiroj këndon vdekjen e të Birit, Tomori i Vogël, 1942*
- Gjon Kolë Kujxhija, "Valle Kombëtare", vëll. I "Dasëm Shkodrane" (Il Cenacolo, Firenze), Leka, shtatuer-tetuer 1943*
- A. Gjergj Fishta OFM, "Mrizi i Zanave", komentuem prej A. Viktor Volaj OFM, Kumbona e së Dieles, 1941*
- Izedin Jashar Kutrulija dhe Mitrush Kuteli, "Sulm e lot", Hylli i Dritës, korrik 1944*
- Arshi Pipa, "Lundërtarët", Hylli i Dritës, korrik 1944*
- 5 - Portrete
- Nji pergamenë, Leka, 1936-37*
- Zi në familje te "Lekës", Leka 1937*
- Në kujtim të Fr. Natale Zanonit S.J., Lajmtari i Zembrës së Krishtit (?)*
- Në vdekje të Fr. Pashko Shestanit S.J., Lajm. i Z. së Kr., 20 gusht 1944*
- Për Zef Harapin, Leka (?)*
- Veteran, Leka, 1937*
- Vdiq Padër Gjergj Fishta, Tomori, 1941, përfshimë në numrin unik mbi Fishtën të A. B. Demës, 1943, fq. 562*
- Fytyra e Fishtës, Kumbona e së Dieles (?)*
- 6 - Kumtesa me karakter informativ historik-shoqnor
- Nisë botimi i njëj vepre monumentale Albanologjike, Gazeta e Shkodrës, 1940*
- Shqipnija Turke dhe Shqipnija Venedike, Tomori, 8.IX.1942*
- Nji kryengritje e Kelmendasve në fillim të shekullit XVIII, Kumbona e së Dieles, 1943 (?)*
- Për historinë e gazetarisë*
- a) *Zanafillat*
- b) *Çpikja e shtypit dhe gazetaria deri me 1700, Shkëndija, 1943*
- Danca, material e mendime për një artikull, Leka, 21 shtator 1944*
- 7 - Botime me karakter folklorik
- Fjalë e të bame të Nastradinit, Leka (?)*
- Martesa shkodrane, në antologjinë "Bota Shqiptare"*
- Gjamë sipas kanunit, Kumbona e së Dieles, nanduer 1943*
- 8 - Përkthime me karakter letrar
- Pjerini i Vogël, Lajmtari i Zembrës së Krishtit, mesi i viteve njëzet*
- Disa poezi japoneze, Leka, nr. 8-9(shtatuer-tetuer), 1943*
- Një nga kangët e poemës finlandeze "Kalevala", Leka, 1943 (?)*
- Made in Japan, Rrezja e Rrethit, 1943*
- Gjuhët e Europës, " " "*
- "Jakoba" e shkrimtares Grazia Deledda, Kumbona e së Dieles, 1943*
- Requiem e Mozart-it, " " "*
- Anekdotat andej e këndeje, " " "*
- Klienti nr. 13, Jean Rameau, " " "*
- Historija e një shpirti – autobiografija e Shenjtes Terezinë e Krishtit Fëmijë, botim i Kumbonës të së Dieles, nr. 15, Shtypshkroja "Shqypja", Shkodër 1944*
- 9 - Poezi të rasëshme
- Kur Mjedja botoi poemën "Lirija", botova një poemë timen në LEKA me shtatë tingllime.*

Në vdekjen e Filip Shirokës, botova në LEKA një tingllim që mbushi plot një faqe të revistës.

Dom Ndre Mjedja (poezi), Leka, nr. 8-9, 1938

Anton Baldaçit (poezi), Leka, 1938

Kur Valentini vuni raftat shkodranë në Albanologjinë Saveriane botova në LEKA poezinë drejtue atij.

Në librin e tregimeve "Atje nën hijen e Rozafës" janë përfshimë, për variacion, disa poezi me karakter tregimtar, që do të ishin po aq tregime-novela: *Nji Valzer*, fq. 27; poezinë e përfshime në tregimin *E shituemja*, fq. 55-56; poezinë e përfshime në tregimin *Lulja e kopshtit tim*, fq. 62-63; *Rromke*, fq. 65-67; *Dallndyshës në vjeshtë*, fq. 85-86.

II – Botimet e mija të periudhës kur kam punue në Institutin e Historisë

Në vitin 1945, për veprimtarinë time letrare, qeshë ftue dhe qeshë ndër anëtarët themelues të Lidhjes së Shkrimtarëve. Pasi qeshë për dy vjet mësues Letërsije në Liceun e Gjirokastrës (1946-1947), qeshë ftue si kuadër në Institutin e Studimeve Shqiptare, të trashiguem nga e kaluemja dhe që, në fillim të vitit 1948, ndryshoi funksion dhe emën: Instituti i Shkencave.

M'u dha detyra të organizoja Arkivin Historik me funksion të shefit teknik, funksion që e mbajta deri me 1951. Pastaj kalova në Sektorin e Historisë së Mesjetës dhe m'u dha detyra të nisja studimet për ndërtimin e historisë politike të perjudhës së parë të pushtimit osman deri në shekullin XVIII.

Gjatë punës sime studimore dhe kërkimore, si në Arkivin Historik ashtu edhe në Bibliotekën Kombëtare, kam pasë përherë kujdes të mos lija asgja me interes pa marrë shënim për studimet e mija. Prandaj kam botue studime edhe në fushë të gjuhësisë, letërsisë, sociologjisë, arkeologjisë, etnografisë.

Kam pasë përherë parasysh, në studimet e mija, të mbështetesh në materialet burimore primare ma fort se në bibliografinë ekzistuese, të cilën e kam korrigjue sepse kam gjetun gabime të shkaktueme nga mos.analiza e mirë e burimeve primare ose nga qëllime politike.

Kam pasë kujdes edhe që rezultatet e studimeve të mija t'i popullarizoj, me aq sa më lejohej, në botime në vete ose ndër të përkohëshme e gazeta të ndryshme.

Prandaj, bibliografinë time të kohës që kam punue në Sektorin e Mesjetës, e kam dallue në dy grupe: a) Studimore; b) Popullarizuese.

A – Bibliografi studimore

1 – Botime studimore në fushën e Historisë Politike

Lëvizja e Leshit edhe ekspedita e Skanderbegut të Ri (1499-1506), Buletini për Shkencat Shoqërore, 1953, nr. 4, fq. 11-30

Luftat e popullit shqiptar kundër pushtimit turk në vjetët 1479-1492, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 1, fq. 76-95

Projektet shqiptare për çlirimin e vendit drejtue Evropës në vjetët 1577-1621, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 4, fq. 116-132

Bashkimi i Maleve shqiptare në fillim të shekullit XVII-të – Ekspedita e Vuço Pashës mbi Kelmend më 1638, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria për Shkencat Shoqërore, 1957, nr. 1, fq. 63-95

Lëvizja shqiptare në kohën e ekspeditës së Karlit VIII n'Itali (1494-1495), Bul. Univ. Sht., 1957, nr. 2, fq. 111-121

Disa fletë të historisë së Shqipnisë në periudhën 1506-1574, Bul. Univ. Sht., 1960, nr. 2, fq. 3-25

Randësia ndërkombëtare e Kuvendeve shqiptare në kalim prej shekullit XVI në të XVII-tin, Bul. Univ. Sht., 1962, nr. 4, fq. 140-152 – ribotue në "Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike", Tiranë

1965, fq. 498-505 – botue në përkthimin italisht (me gabime në ndonjë rast rranjësores) në: “Rassegna di Studi Albanesi”, nr. 1, 1963, fq. 101-109

Kontribut për Historinë e Shqipërisë bregdetare në fillim të shek. XVI – Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpjekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare, Studime Historike, 1964, nr. 1, fq. 95-123

Shënime mbi disa çashtje të Lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk, Stud. Hist., 1965, nr. 1, fq. 149-155

Aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare në shekujt e parë të pushtimit otoman veçanërisht në vjetët 1593-1620, Stud. Hist., 1967, nr. 3, fq. 113-128

Emni dhe tradita e Skënderbeut në përpjekjet e Shqiptarëve për liri gjatë shekujve të parë të pushtimit otoman, Stud. Hist., 1967, nr. 4, fq. 93-104

Rëndësia ndërkombëtare e kryengritjeve shqiptare kundër pushtimit otoman – Nga një dokument i pabotuar i vjetit 1567, Stud. Hist., 1970, nr. 2, fq. 167-201

2 – Vëllimet e botimeve Dokumentare për Historinë e Shqipërisë me parathënie studimore

RELACIONE mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII

Vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963, fq. 1-538

Vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965, fq. 1-525

DOKUMENTA të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë

- pjesa e parë (1479-1499), Tiranë 1967, fq. 1-309

- pjesa e dytë (1499-1506), Tiranë 1979, fq. 1-559

REGJISTRIT i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, Tiranë 1977, fq. 1-499

DOKUMENTE të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë

- vëllimi i parë (1507-1592), Tiranë 1989, fq. 1-490

- vëllimi i dytë (1593-1602), Tiranë 1990, fq. 1-387

- vëllimi i tretë (1603-1621), Tiranë 1989, fq. 1-465

- vëllimi i katërt (1675-1699), bashkëautor me Selami Pulahën, Tiranë 1990, fq. 1-569

DOKUMENTE për Historinë e Shqipërisë të shek. XV, bashkëautor me Luan Malltezin, vëllimi i parë (1400-1405), Tiranë 1987, fq. 1-712

[Shënim: Pas vdekjes janë (ri)botuar:

DOKUMENTE për historinë historinë e Shqipë e Shqipërisë (1623-1653)- Documenti per la storia dell'Albania (1623-1653), St. Gallen. Prishtinë 2014, fq. 1-577

RELACIONE E DOKUMENTE për historinë e Shqipërisë (1610-1650) - RELAZIONI E DOCUMENTI per la storia dell'Albania (1610-1650), St. Gallen- Prishtinë 2018, fq. 1-842- **J.Z.**]

3 – Përmbledhje e studimeve historike

Përpjekjet e Shqiptarëve për liri në dy shekujt e parë të pushtimit otoman, N.Sh.B. “Naim Frashëri”, Tiranë 1962, fq. 1-125

Bashkëpunëtor në tekstet e historisë për periudhën e pushtimit otoman

4 – Marrëdhëniet feudale

Shënime mbi një lëvizje fshatare në Shqipëri më 1607, Bul. Univ. Sht., 1961, nr. 1, fq. 135-147

Diskutim rreth kumtesës së Z. Shkodrës “Të dhana të reja mbi legjislacionin e esnafëve në Shqipëri gjatë qindvjeçarit XVI-XVII”, Konf. e parë e Stud. Alb.- Tiranë 15-21 Nëntor 1962, Tiranë 1965, fq. 664-665

Disa të dhana për qytetin e Shkodrës në tridhjetvjetorin e parë të pushtimit otoman, Stud. Hist., 1966, nr. 3, fq. 47-60

Të dhana mbi potencialin ekonomik të një shtëpie feudale shqiptar në shekullin XV – me dokumentin origjinal të zbuluem në familjen e Kolë Kamësit, Stud. Hist., 1979, nr. 2, fq. 175-198

Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve, Stud. Hist., 1980, nr. 3, fq. 169-187

5 – Studime mbi burimet e reja dokumentare

Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për Historinë e Shqipnisë, Bul. Shk. Shoq., 1955, nr. 3, fq. 122-130

Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike dhe shoqnore të shekullit XVII – Relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrimën dhe regjesti i 72 dokumentave të rij, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 2, fq. 157-198

Relacioni i Pjetër Budit drejtue kardinalit Gozzadino me 1621, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 2, fq. 79-92

Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek. XVII – Relacioni i Frang Bardhit mbi Pukën, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 3, fq. 170-215

Rindërtimi i Mbishkrimit të Arbërit dhe mundësitë e reja për leximin e tij, Iliria, 1984, nr. 2, fq. 207-218

6 – Studime në fushën e sociologjisë

Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shekullit XVII – Të dhana mbi diferencimin shoqnor – Bul. Univ. Sht., 1959, nr. 1, fq. 3-20

Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas kanunit, Bul. Univ. Sht., 1961, nr. 2, fq. 101-132

7 – Në fushën e kritikës historike

Angelo Tamborra, Gli Stati Italiani, l'Europa e il problema turco dopo Lepanto (Shtetet italiane, Evropa dhe problemi turk pas Lepantit), Firenze, Leo S. Olschki edit. MCMLXI – *Biblioteca dell'Archivio Storico Italiano*, XIII, pp. 1-94, St. Hist., 1964, nr. 2, fq. 231-234 – *Studia Albanica*, 1964, nr. 1, fq. 257-261, italisht

Bistra Cvetkova, Mouvements antiféodaux dans les terres bulgares sous domination ottomans du XVI au XVII s. (Lëvizje antif feudale në tokat bullgare nën pushtimin otoman nga shek. XVI në të XVII-in) – Études historiques à l'occasion du XII-e Congrès International des Sciences Historiques, Vienne, août et septembre 1965, Tome II, Sofia 1965, fq. 149-168, Stud. Hist., 1966, nr. 1, fq. 159-164

8 – Nismëtarët e Letërsisë Shqipe të inkuadruem në Lëvizjet çlirimtare

Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit, Bul. Shk. Shoq., 1954, nr. 3, fq. 39-56

Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit – Letra drejtue me 1621 kardinalit Gozzadino, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 2, fq. 67-94

Diskutim rreth kumtesës së prof. Selman Rizës “Dy versionet e veprës së Pjetër Bogdanit”, në Konferencën Albanologjike 1962, Konf. e parë e St. Alb. – 15-21 Nëntor 1962, Tiranë 1964, fq. 401-403

Diskutim për kumtesën e prof. Mahir Domit “Rreth Autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të Ungjillit”, në Konferencën Albanologjike 1962, Konf. e parë etj., Tiranë 1965, fq. 399-400

Shënime rreth disa të dhanave mbi Bibliografinë e Letërsisë shqipe të vjetër. Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 1, fq. 233-237

Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin, Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 2, fq. 199-207

Pjetër Mazrreku dhe Fjalorthi i tij i vjetit 1633, Studime Filologjike, 1964, nr. 2, fq. 167-174 – *Studia Albanica*, 1964, nr. 2, fq. 129-136

Barleci apo Bardheci?, Stud. Fil., 1970, nr. 3, fq. 171-177

Qëmtime për Budin e Bardhin, Stud. Hist., 1985, nr. 1, fq. 165-176

Mbi rrethanat historike të botimit të “Mesharit” të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në Letërsinë e Vjetër Shqiptare, Stud. Fil., 1986, nr. 3, fq. 185-204

9 – Përpyekje për alfabetin, gjuhën shqipe dhe për arsim

Zbulimi i një dokumenti të vjetër shqip, 1948, nr. 2-3, fq. 79

Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas, Bul. Inst. Shk., 1949, nr. 1, fq. 55-57

Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit – transliterim, transkriptim dhe koment, Bul. Inst. Shk., 1951, nr. 3-4, fq. 64-131

- Një dorëshkrim bektashjan i gjysmës së dytë të shek. XIX*, Bul. Shk. Shoq., 1955, nr. 4, fq. 203-210
- Kontribut për historikun e alfabetit tonë*, Bul. Shk. Shoq., 1957, nr. 1, fq. 184-200
- Elemente të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shekujt XVI-XVII*, Stud. Hist., 1965, nr. 3, fq. 37-59
- Letër në redaksi – Rreth disa formulimeve të gabueme në artikullin “Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII, “Studime historike”, 1965, nr. 3, fq. 37-59*, Stud. Hist., 1967, Nr. 2, fq. 195-199
- [Shënim:** Mbas kritikave kundër ideve të autorit që arritën kulmin me mbledhjet e fletë-rrufetë e shumta kundër tij në periudhën e “revolucionarizimit” 1966-67, autori detyrohet, më në fund, të përgjigjet me këtë “Letër në Redaksi”. Për sqarimin më të mirë të lexuesve rekomandojmë kumtesën “Historia evropiane e Injac Zamputtit” botuar në gazetën “Shekulli”, Nr. 2878, 14 shkurt 2010, fq. 16-17, mbajtur nga Pëllumb Xhufi në përkujtimin e 100-vjetorit të lindjes së autorit - **J.Z.**]
- 10 – *Të ndryshme*
- Gjurmime në toponiminë historike – Rogozhinë-Raguzin?*, Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 4, fq. 77-82
- Pashko Vasa, Burgimi im – Episod historik, 1850, e përktheu nga italishtja dhe e pajisi me fjalë hyrëse dhe shënime, Injac Zamputi*, në Pashko Vasa, Vepra letrare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1987, fq. 135-293
- 11 – *Esé-kritike*
- Eskursion në dy vepra të Kadaresë: 1 – Ekskursion në librin “Autobiografia e popullit në vargje”; 2 – Ekskursion në librin “Eskili, ky humbës i madh”, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 1993, fq. 1-235*
- Fishta – koha, njeriu, vepra*, Shtëpia botuese Pasqyra, Tiranë 1993, fq. 1-175

B – Botimet me karakter popullarizues

Para se të demaskohej ideologjija ime, në pranverën e vitit 1968, çdo organ (me përjashtim të “Zërit të Popullit”) më kërkonte shkrime. Kam regjistruar vetëm disa.

- Si e njoha unë Ndre Mjedën*, Revista Nëndori, viti VIII, nr. 8, gusht 1960, fq. 203-214
- 500-vjetori i dokumentit ma të hershëm të shkrimit shqip*, Gazeta Bashkimi, 9 nëndor 1962, fq. 3
- Një pasardhës i Skënderbeut në krye të luftëtarëve shqiptarë në luftën e Klishit më 1596*, Gazeta Mësuesi, viti V, nr. 27(201), 2 korrik 1965, fq. 4
- Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit (Me rastin e 400 vjetorit të lindjes)*, Rev. Nëndori, viti XIII i botimit, 1966, nr. 9, fq. 123-142
- Randësia e lëvizjes së armatosun shqiptare më 1481, kur erdhi dhe u vu në krye të saj djali i Skënderbeut, Gjoni*, Gaz. Mësuesi, 21 prill 1967
- Dokumenta dhe materiale për zhvillimin e luftës së Himarës më 1492*, Gazeta Zëri i Rinisë, 20 maj 1967
- Në ç’rrethana historike ngjau ekspedita e Bajazidit të dytë në Shqipëri më 1492*, Gaz. Zëri i Rinisë, nr. 59(1954), e shtunë 15 korrik 1967, fq. 4 në 3 shtylla
- Dëshmi e forcës së paepun të popullit shqiptar – Rrethimi i Krujës më 1467*, Revista 10 Korriku, 1967/VII
- I biri i Skënderbeut, Gjon Kastrioti, dhe lëvizja e armatosur në Shqipëri më 1481 – Dokumenta dhe materiale*, Gaz. Zëri i Rinisë, e shtunë 13 gusht 1967
- Ekspedita e Bajazidit të dytë më 1492 – dokumentacion*, Gaz. Zëri i Rinisë, 26 gusht 1967
- Damjani Himariot – 25 korrik 1537*, Revista Ylli, gusht 1967

Në pranverën e vitit 1968 po përgatitej demaskimi i im dhe punimi i fundit “*Lëvizja e armatosun shqiptare më 1494-1506 dhe ekspedita e Skënderbeut të Ri në Lezhë*” dorëzue për gazetën “Zëri i

Rinisë” nuk u botue. Deri më 1987 nuk më lejohej botimi në organet e ndryshme. Në këtë vit (1987) m’u hap rruga për me botue studimet e mija në organet e ndryshme; edhe në gazetën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve “Drita”.

Fakte – mendime – gjykime, në librin e Pashko Vasës “Burgimi i im”, Gazeta Drita, viti XXVII, 25(1389), 14 qershor 1987, fq. 12 (Për këtë artikull mora çmimin e tretë)

Kumtesë për një shtatëdhjetëvjetor të ndritur – Më 1917, në kuadrin e veprimtarisë së Komisionit Letrarë shqipe, hapet shkolla e parë laike për vajzat në Shkodër, Gaz. Drita, viti XXVII, 38(1402), 13 shtator 1987, fq. 12

Fjala e shkruar e bën edhe më dëshmues objektin arekologjik – Dy rezultate të rëndësishme të arkeologjisë dhe të epigrafisë, Gaz. Drita, viti XXVIII, 3(1420), 17 janar 1988, fq. 12

As roman, as legjendë historike, por histori legjendare – Për jetën dhe luftat e kelmendasve, Gaz. Drita, viti XXVIII, 21(1438), 22 maj 1988, fq. 12

Në emër të lirisë: përballë sulltanit dhe perandorit, Gaz. Drita, viti XXVIII, 28(1445), 10 korrik 1988, fq. 12

Pjetër Bogdani – luftëtar në të gjitha frontet për idealin shqiptar, Gaz. Drita, viti XXIX, 10(1479), 5 mars 1989, fq. 12

Rubrika “Punëtorë të penës, burra të aksionit”: Buzuku, Meshari dhe Pashënia, Gaz. Drita, viti XXIX, 20(1498), 16 korrik 1989, fq. 12

Poeti përkthen poetin – Skicë në formë të një kritike, Gaz. Drita, viti XXIX, 37(1506), 10 shtator 1989, fq. 12

Marin Barleti dhe vepra e tij madhore, Gazeta Drita, 25 Nëntor 1990, fq. 7 dhe 11

Botime në revistën “Hylli i Dritës” në vitet ‘90

Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe – Hylli i Dritës, 1995, Nr. 1-2, fq. 14-51
Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit – H. Dr., 1995, Nr. 5-6, fq. 16-29

Mbi disa fjalë të kristalizueme në lutjet e në praktikën fetare katolike – H. Dr., 1996, Nr. 1-2, fq. 9-17
Valbona – argumente dhe dëshmi në lidhje me prejardhjen e këtij toponimi – H. Dr., 1996, Nr. 3-4, fq. 68-79

Portreti i Fishtës në objektivin tim – H. Dr., 1996, Numër i posaçëm, fq. 24-28

Mirësetëvijë në konak të vet Fishta, i mërguar ... - H. Dr., 1996, Numër i posaçëm, fq. 256-276

Përsaktësime në toponiminë me fiset përkatëse n’aksionin kolonizues të Dionisit e në luftat Iliro-Romake – H. Dr., 1997, Nr. 1-2, fq. 25-49

Regesti Kamsi – H. Dr., 1997, Nr. 5-6, fq. 70-95 (Shënim: Ky është punimi i fundit që ka botuar kur ishte gjallë. Punimet e mëposhtme janë botuar nga dorëshkrimet e lëna – J.Z.).

Kujtime për Dom Ndre Mjedjen – H. Dr., 2011, Nr. 2, fq. 122-141

Gjon Kolë Kujxhija – H. Dr., 2011, Nr. 3, fq. 131-136

Kronika e Shkodrës 1831-1839 – H. Dr., 2011, Nr. 4, fq. 69-84 (Shënim: Është botuar me emrin e autorit të kronikës, Zef Bubçi, dhe vetëm përkthimi e shënimet pa origjinalin e transkriptuar – J.Z.).

Çashtja e kombësisë në shekullin e XVII-të – H. Dr., 2012, Nr. 2, fq. 49-52

Shënime për fazën përfundimtare të lëvizjes shqiptare dhe të ekspeditës së Gjon Kastriotit më 1481 – H. Dr., 2013, Numër jubilar me rastin e 100-vjetorit të themelimit, fq. 277-300

JETËSHKRIM I INJAC ZAMPUTTIT

Lindi në Shkodër më 12.02.1910 në një familje të mesme. I jati, Romolo, me origjinë italiane, zyrtar poste, vdes shpejt pas një aksidenti duke e lënë jetim në moshën njëvjeçare së bashku me tri motra. E ëma, Nine, me origjinë nga malësia, nga Temali, i rrit këta fëmijë me mundime e sakrifica.

Studjon në Kolegjin Saverian të Jezuitëve në Shkodër ku shquhet për korrektësi dhe rezultate shumë të mira. Prandaj, qysh në moshën 21 vjeçare mbahet në atë Kolegj ku jep lëndën e letërsisë shqipe si koleg i ri i Dom Ndre Mjedës. Merr pjesë në mjaft shfaqje teatrore, në fillim si nxënës e më vonë si drejtues. Po kështu merr pjesë në shfaqje muzikore duke i rënë violinës e mandolinës si amator. Jep ndihmesë të madhe në revistën "Leka" si bashkëpunëtor i A. Zef Valentinit. Si mësues i ri dallohet në aktivitetet kulturore, artistike e sportive me nxënësit.

Ndër nxënësit e tij mund të përmendim: V.Stafën, L.Boriçin, Q.Stafën, S.Bekteshin etj. (Duhet shënuar se në atë Kolegj studionin edhe nxënës të besimeve të tjera). Më 1937 martohet me një vajzë shkodrane, Rozën, nga familja e Prelajve dhe patën 6 fëmijë: 5 vajza e 1 djalë. Ndërkohë mbaron universitetin me korrespondencë në Trieste ku doktorohet në shkencë politike e mbron temën historike: "700-a Veneciane dhe Shqipëria Turke", pa e ditur se e ardhmja e jetës së tij do të ishte pikërisht historia e mesjetës e Shqipërisë. Pas mjaft shkrimeve, artikujve, poezive, përkthimeve etj. në shtypin e kohës me pseudonime të ndryshme, më 1940 boton vëllimin e parë me novela "Zemra njerzish" e më 1944 vëllimin e dytë me novela "Atje, nën hijen e Rozafës" dhe melodramin "Damjani himarjot". Në vitet e fundit në Kolegjin Saverian, së bashku e nën drejtimin e A. Z. Valentinit, hedhin bazat e albanologjisë shqiptare e kjo do t'i shërbejë si bazë e mirë për studimet e mëvonshme historike të tij.

Pas luftës, më 1945, punon si drejtues i Shtëpisë së Kulturës në Shkodër e më pas, 1946-48, dërgohet në Gjirokastrë si mësues letërsie në liceun e atij qyteti. Me hapjen e Institutit të Shkencave thirret në Tiranë ku i caktohet sektori i historisë së mesjetës. Në vitin 1949 (sipas gazetës "Panorama" të 30 nëntorit 2009 mbi dosjen e E. Çabejt dhe sipas kujtimeve të lëna nga vetë Injaci) fillon një presion i madh mbi të për t'u rekrutuar nga Sigurimi i Shtetit, por ai refuzon në mënyrë kategorike. Për këtë refuzim nuk foli me askënd gjithë jetën dhe pasojat e këtij refuzimi e ndoqën gjithnjë atë dhe familjen e tij.

Qëndron, deri më 1953, i vetëm në Tiranë, ku, më në fund, i jepet shtëpi vetëm me një dhomë, paradhomë e guzhinë për familjen me 10 vetë (nëna, motra, gruaja e 6 fëmijët), me tri familje të tjera në një korridor e një banjo të përbashkët. Aty punoi e jetoi për 40 vjet e aty i shkroi veprat e tij herë në stol, herë në tavolinën e vogël e herë në prehër, duke u kërrusur gjithnjë e më shumë mbi dokumentat e historisë pa kërkuar asgjë e pa i trokitur në derë askujt. I hyri punës me pasion, sepse kështu gjeti mënyrën për të shprehur intelektin e bagazhin e tij, për të mbajtur familjen e për të mbijetuar.

Ndër punimet e para është zberthimi i alfabetit të dorëshkrimit të quajtur "Anonimi i Elbasanit", transkriptimi e komentimi i tij, duke e çuar së paku në shek. XVII lëvizjen e ritit ortodoks për një liturgji në gjuhën shqipe. Po kështu zberthen alfabetin e panjohur të shek. XIX të një poezie me përmbajtje bektashiane.

Më pas boton librin "Përpykjet e shqiptarëve për liri e pavarësi në shek. XVI-XVII". Fillon të përgatisë kuadrin e ri për dokumentacionin e periudhës së mesjetës, u jep drejtime se ku të shkojnë për ta kërkuar në arkivat e ndryshme të Venecias, Vatikanit, Raguzës etj. Ia sjellin këto dokumenta me mikrofilma e ai, nga fotokopjet, duke përdorur shpesh thjerrëzën, i transkripton, i përkthen, i komenton e kështu boton 10 vëllime në kuadrin e Institutit të Historisë me relacione, regjistra, shënime të ndryshme të asaj kohe. Ai vetë nuk u lejua asnjëherë të dilte nga Shqipëria për gjetjen e dokumentacionit ose për të marrë pjesë në kongrese, konferenca apo simpoziume të ndryshme ku ftohej nga të

huajt. Shkolla që kishte kryer, kultura që kishte marrë nga Jezuitët, kontaktet që kishte pasur para lufte e bënin person të dyshueshëm që duhej mbajtur nën mbikqyrje nga regjimi.

Kështu, me punën e tij të palodhshme, u mbush ai boshllëk i madh që ekzistonte në periudhën e historisë së Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut, duke nxjerrë në pah organizimin e maleve për luftën kundër otomanëve, kuvendet shqiptare, kontaktet me Europën etj. Konkluzionet e studimeve të dokumentacionit botoheshin në formë artikujsh në "Buletini për Shkencat Shoqërore" e më pas "Studime historike". Nga dokumentacioni i kohës zbulon e studjon mjaft hollësi të shkrimtarëve të vjetër shqiptarë Buzuku, Bardhi, Budi, Bogdani e të humanistëve shqiptarë Barleti e Beçikemi.

Të periudhës 1960-1990 janë vëllimet:

RELACIONE mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII

Vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963, fq. 1-538

Vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965, fq. 1-525

Ribotim

RELACIONE E DOKUMENTE për historinë e Shqipërisë (1610-1650) - RELAZIONI E DOCUMENTI per la storia dell'Albania (1610-1650) St. Gallen- Prishtinë 2018, fq. 1-842

DOKUMENTA të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë

- pjesa e parë (1479-1499), Tiranë 1967, fq. 1-309

- pjesa e dytë (1499-1506), Tiranë 1979, fq. 1-559

REGJISTRI i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, Tiranë 1977, fq. 1-499

DOKUMENTE të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë

- vëllimi i parë (1507-1592), Tiranë 1989, fq. 1-490

- vëllimi i dytë (1593-1602), Tiranë 1990, fq. 1-387

- vëllimi i tretë (1603-1621), Tiranë 1989, fq. 1-465

- vëllimi i katërt (1675-1699), bashkëautor me Selami Pulahën, Tiranë 1990, fq. 1-569

DOKUMENTE për Historinë e Shqipërisë të shek. XV, bashkëautor me Luan Malltezin, vëllimi i parë (1400-1405), Tiranë 1987, fq. 1-712

DOKUMENTE për historinë e Shqipërisë (1623-1653)- Documenti per la storia dell'Albania (1623-1653) St. Gallen-Prishtinë 2014, fq. 1-577

Të gjitha këto vëllime janë botuar me transkriptimet origjinale, përkthimet përkatese, me indeksat e emrave të personave e të vendeve dhe me shpjegimet e duhura. Vetëm në këto vëllime dokumentash numërohen më shumë se 5000 faqe.

Në vitet '50 e fillimet e viteve '60 merret edhe me letërsi e përkthime. Shkruan tri drama, një melodramë, dy tregime të gjata, një poemë për luftën e Himarës 1481, por nuk lejohen të botohen. Në vitet '50 përkthen operan "La Bohème" që vihet në skenë, por më pas venë dorë të tjerët, me pretekstin e dialektit verior të përdorur, në mënyrë që të mos dilte më emri i tij. Po kështu përkthen komedinë e Goldonit "La Locandiera" (Zoja e bujtinës) që ka të njejtin fat si opera. Kështu, heq dorë nga letërsia e përkthimet dhe i kushtohet krejtësisht historisë e paleografisë. E vetmja dramë që arriti të dëgjohet vetëm një herë në radio e inçizuar nga studentët e degës së dramës të ILA më 1965 që drama "Guri i themelit" me temë mbi Kalanë e Rozafatit.

Vijnë vitet e zeza 1967-68 - revolucioni kulturor - e ai është në shenjestër për ideologjinë e tij fetare e për të kaluarën e tij duke u sulmuar me fletë-rrufe e me mbledhje të pafund. Por ai e përballon edhe këtë sulm e gjithnjë me pasion, më shumë i mbyllur në shtëpi, vazhdon e punon duke jetuar me botën e Budit, Bogdanit, Bardhit etj. (Për të kuptuar më mirë këtë sulm dhe si e përballoi, rekomandojmë kumtesën "Historia evropiane e Injac Zamputtit" botuar në gazetën "Shekulli", Nr. 2878, 14 shkurt 2010, fq. 16-17, mbajtur nga Pëllumb Xhufi në përkujtimin e 100-vjetorit të lindjes së autorit).

Asnjëherë nuk ia njohën titullin doktor e laurën e Triestes, megjithëse pothuajse të gjithë e thërrisnin: "Profesor". Nëse deri në vitin 1967 boton në organet e ndryshme (me përjashtim të "Zërit të Popullit") shkrime mbi rezistencën e popullit shqiptar mbas vdekjes së Skënderbeut, mbi

shkrimtarët e vjetër etj., mbas këtij viti e deri në vitin 1987 nuk lejohet më të botojë nëpër organe të ndryshme, përveç "Buletinit" e "Studime Historike".

Të vitit 1984 janë punimet e tij me shumë interes për leximin e "Mbishkrimit të Arbërit" e "Mbishkrimit të Brarit" të cilët lexohen për herë të parë në mënyrë të plotë dhe që vendosin gurë themeli në historinë e popullit shqiptar.

Në fundin e viteve '80 e ndjen se do të ndodhnin ndryshime të medha. Përkthen më 1989 "Burgimet e mija" të P. Vasës duke e pajisur me parathënie e shënime të ndryshme. Ftohet po atë vit edhe në një emision televiziv kushtuar figurës së atij rilindasi. Të periudhës së viteve të para të demokracisë janë dy librat e tij: "Fishta - koha, njeriu, vepra" dhe "Ekskursion në dy vepra të Kadaresë" (1993). Në vitet 1995-97 boton artikuj e studime me shumë interes në revistën "Hylli i Dritës" për çështje të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe, për aksionin kolonizues të Dionisit e lufrat iliro-romake, etj.

Më 1995 nga Presidenti i Republikës i jepet dekorata "Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës" me motivacionin "Për kontribut shumë të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike".

Mbylli sytë më 28. 02. 1998 në Tivoli të Italisë dhe, sipas porosisë së tij të fundit, eshtrat e tij prehen në varrin e familjes në Tiranë, në Shqipëri, në atë vend, historisë së të cilit i kushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij.

Shënim: *Vetëm gjatë periudhës së diktaturës ai dhe familjarët e tij e kanë shkruar mbiemrin me një t: ZAMPUTI, por deri më 1944 e në të gjithë regjistrat e gjendjes civile, edhe të periudhës së diktaturës, mbiemri shkruhet me dy t: ZAMPUTTI.*

(Përgatiti: Jozef Zamputti)